REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fax/Br.str. 229
Data/Datum 07.07.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

RR E G U LL O R E
PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Qershor 2026

Bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 34, paragrafi 34.4, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit nenin 17, paragrafi 1, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27.2008), nenin 36, paragrafi 3, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013 - Ministria e Financave - shpenzimi i parave publike, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 30.06.2026, pas shqyrtimit të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, miraton:

RR E G U LL O R E
PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktoj kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të personave fizik dhe juridik, me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent, gjithë përfshirës dhe llogaridhënës për financim me fonde publike të projekteve dhe aktiviteteve të personave fizik dhe juridic, që janë në interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 2
Përkufizimet

1. Rregullore - është akt nënligjor që miratohet nga numri i kërkuar i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, që rregullon një lëmi të caktuar të kompetencave të saj.
2. Subvencionet - në kuptim të kësaj rregulloreje, subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat.
3. Personat Juridik - nënkupton ndërmarrjen, entin, shoqatën, klubin e tjera. Me identitet sipas të dhënave të regjistrave të personave juridik.
4. Personat Fizik - nënkupton qytetarin me identitet sipas të dhënave të regjistrave të gjendjes cvile.
5. Përfituesi - nënkupton personat fizike dhe juridike që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e komunës dhe në pajtim me Ligjin për Ndarjet Buxhetore.
6. Thirrja publike - nënkupton njoftimin publik për pranimin e aplikimeve.

7. Mbështetja Financiare - nënkupton çdo forme e mbështetjes për persona fizik dhe juridik, e cilat shprehet në vlerë monetare, pa marr parasysh emërtimin e saj.
8. Komisioni - në kuptim të kësaj rregulloreje, nënkupton komisionin përkatës të themeluar nga Kryetari i Komunës.

Neni 3
Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin fiskal, për të cilin ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj si vijon:

1.1 Komuna ndan subvencione për këto fushën e arsimit, zhvillimit ekonomik, bujqësinë, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, kulturë, rini dhe sport, shërbime publike e siguri, pastaj Kabineti i Kryetarit të Komunës, si dhe duke mos u kufizuar edhe në fusha tjera.

1.2 Ndarja e subvencioneve sipas kësaj rregulloreje, do të zbatohet për të gjitha rastet, ashtu siç është paraparë në nenin 2, pika 5 të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare.

Neni 4
Subjektet përfituese të subvencioneve

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizikë, Organizata Jo Qeveritare dhe në raste të veçanta personat juridikë që ndërlidhen me ndonjë aktivitet nga fushat e përcaktuara me këtë rregullore.
2. Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve bëhen në mënyrat si vijon:

2.1 Procedura e ndarjes së subvencioneve nga komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta, në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje;

2.2 Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të komunës, përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi;

2.3 Këto procedura zhvillohen në pajtim me Regulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017, si dhe me dispozitat e parapara të kësaj rregulloreje;

2.4 Ndarja e subvencioneve sipas kërkesave të veçanta aplikohet për kategorinë e subvencioneve të cilat i ndan Kryetari i Komunës, në të gjitha fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

3. Subjektet perfituese sipas paragrafit 2 të këtij neni, për të njëjtin projekt nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Kryetarit të Komunës sipas paragrafit 3 të këtij neni.
4. Përfitues të subvencioneve të ndara nga komuna nuk mund të jenë personat fizikë jorezidente të Komunës së Fushë-Kosovës.
5. Asnjë subjekt nuk mund të jetë përfitues i subvencioneve, nëse paraprakisht nuk e ka mbyllur subvencionin paraprak në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratën për ndarjen e subvencioneve.

Neni 5
Subvencionet në fushën e arsimit

1. Komuna mund të ndajë subvencione për fushën e arsimit duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

1.1 Bursa për studentë;
1.2 Mbështetje për studentët e drejtimeve deficitare dhe shkencore;
1.3 Mbështetja për studentët e studimeve të doktoratës;
1.4 Mbështetja për nxënës me nevoja të veçanta;
1.5 Botimin e librave/revistave dhe materialeve edukativo-arsimore dhe
1.6 Mbështetja për aktivitete edukativo-arsimore, përfshirë trajnime, gara dhe olipiada vendore dhe ndërkombëtare.

2. Subvencionet sipas këtij neni mund të jepen në format:

2.1 Bursa financiare;
2.2 Tekste shkollore falas;
2.3 Rimbursim financiar për bursa dhe literaturë dhe
2.4 Mbështetje për pjesëmarrje në gara, trajnime dhe konferenca.

3. Përfitues të subvencioneve sipas këtij neni janë vetëm banorët e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Komuna shpall thirrje publike për aplikim, e cila publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës, rrjetet sociale dhe mediat locale.
5. Sistemi i poentimit dhe kriteret e përzgjedhjes janë 100 pikë dhe realizohet si vijon:

5.1 Nota mesatare 40 pikë;
5.2 Drejtimet deficitare dhe shkencore 25 pikë;
5.3 Institucioni dhe vendi i studimit 10 pikë;
5.4 Niveli i strudimit 10 pikë;
5.5 Gjendja socio-ekonomike 10 pikë;
5.6 Kategoria sociale 5 pikë.

6. Institucioni dhe vendi i studimit vlerësohet me 10 pikë.

6.1 Vlerësimi i këtij kriteri bëhet si vijon:
6.1.1 Universitetet publike në Republikën e Kosovës 10 pikë;
6.1.2 Universitetet private në Republikën e Kosovës 6.5 pikë;
6.1.3 Shtetet e rajonit 7 pikë;
6.1.4 Lindja e Afërt 8 pikë;
6.1.5 Lindja e Largët 9 pikë;
6.1.6 Bashkimi Evropian 10 pikë dhe
6.1.7 Amerika Veriore / përtej Atlantikut 10 pikë.
6.2 Universitetet publike vlerësohen me 50% më shumë pikë se Univeristetet private.
6.3 Vlerësimi bazohet vetëm në institucionet e akredituara zyrtarisht në shtetin përkatës.

7. Niveli i studimit vlerësohet më 10 pikë

7.1 Vlerësimi i këtij kriteri bëhet si vijon:
7.1.1 Bachelor 5 pikë;

7.1.2 Master 10 pikë dhe
7.1.3 Doktoratë vlerësohet sipas thirrjes së veqantë publike.
8. Koeficienti i bursës sipas nivelit të studimit, pas përcaktimit të kategorisë së përfitimit sipas pikëve, shuma e bursës përcaktohet edhe sipas nivelit të studimit si vijon:
8.1 Bachelor - 100% e shumës së kategorisë përkatëse;
8.2 Master - 110% e shumës së kategorisë përkatëse dhe
8.3 Doktoratë.
9. Kategorizimi i përfitimit, pikët kategoria dhe përqindja e bursës është si vijon:
9.1 90 - 100 I 100%;
9.2 80 - 89 II 75%;
9.3 70 - 79 III 50%;
9.4 60 - 69 IV 35%;
9.5 50 - 59 V 20%;
9.6 Nën 50% - nuk përfiton.
10. Dispozitat financiare.
10.1 Në rast të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare - Komuna aplikon koeficient proporcional të zvogëlimit për të gjithë përfituesit në mënyrë të barabartë.
10.2 Shuma bazë e bursës përcaktohet me thirrje publike dhe miratohet nga Kryetari i Komunës.
11 Barazia e pikëve, në rast të pikëve të barabarta, përparësi i jepet:
11.1 Kandidatët me notë mesatare më të lartë;
11.2 Kandidatët me gjendje më të rëndë socio-ekonomike dhe
11.3 Kandidatët që i përket kategorive sociale prioritare.
12 Lista përfundimtare - Komisioni vlerësues harton listën preliminare dhe përfundimtare në bazë të këtij neni.

Neni 6
Dokumentet e nevojshme

1. Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave - Kriteret e përgjithshme janë si vijon:
1.1 Nota mesatare;
1.2 Numrin e studenteve/nxënësve në familje;
1.3 Kategoritë e dala nga lufta vetëm për studentë;
1.4 Gjendja ekonomike;
1.5 Mungesën e prindërve të studentit;
1.6 Aftësinë e kufizuar të studentit;
2. Kriteret specifike janë:
2.1 Kuotimi i notës mesatare;
2.2 Vendi dhe profili i studimit;
2.3 Kategoria e studentit dhe
2.4 Specifikat e studimit / kategoria dhe nevoja e profileve
3. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kritere të qarta për dhënien e

bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë:

4.1 Dokumentin e identifikimit;

4.2 Certifikatën e notave;

4.3 Certifikatën e vitit kalendarik të studimeve;

4.4 Certifikatën e vendbanimit;

4.5 Dëshminë mbi gjendjen ekonomike dhe

4.6 Dëshminë se prindërit i përkasin kategorive të dala nga lufta.

5. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë kalendarik ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga niveli qendror, ose ndonjë donator tjetër për fushën e njejtë.
6. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave, e cila publikohet në ueb-faqen e komunës, mediet sociale dhe në medie lokale.
7. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me thirrjen publike sipas Drejtoriss përkatëse dhe të miratuara nga Kryetari i Komunës.

8 Përfituesit e subvencioneve sipas këtij neni, duhet të jenë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 7

Subvencionet për fushën e zhvillimt ekonomik

1. Subvencionet për fushën e zhvillimit ekonomik dhe rural ndahen për të promovuar zhvillimin e bizneseve individuale dhe të vogla.
2. Komuna mund të ndajë subvencione për fushën e zhvillimit ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

2.1 Zeje bashkëkohore dhe tradicionale;

2.2 Agrobiznes;

2.3 Ndërmarrje publike;

2.4 Biznes inovativ;

2.5 Ndërmarrje sociale;

2.6 Aktivitetet e shoqatave që ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin;

2.7 Bizneset e reja ose fillestare;

2.8 Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;

2.9 Inkurajimin e punësimit të qëndrueshëm të gjinisë së nën-përfaqësuar në këtë sektor.

3. Përfitues të subvencioneve për fushën e zhvillimit ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës.

4 Përfitues të subvencioneve për fushën e zhvillimit ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe të Administratës Tatimore të Kosovës.

Neni 8
Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për fushën e zhvillimit ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për fushën e zhvillimit ekonomik, në kushte të barabarta, komuna u jep përparësi rasteve specifike, si në vijim:

1.1 Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
1.2 Grave, të rinjve, veprimtarive në zona rurale, personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve etnike;
1.3 Bizneseve të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale;
1.4 Organizatat Jo Qeveritare të cilat aplikojnë me projekte biznesi, që mundësojnë gjenerim të vendeve dhe
1.5 Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të një subvencioni për fushën e zhvillimit ekonomik, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për fushën e zhvillimit ekonomik, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

2.1 Planin e biznesit;
2.2 Dokument identifikues;
2.3 Certifikatën e vendbanimit për persona fizikë;
2.4 Certifikatën e biznesit;
2.5 Dëshminë për pagesën e taksave komunale;
2.6 Dëshminë për pagesën e tatimit në pronë;
2.7 Dëshminë se nuk ka obligime ndaj Administratës Tatimore të Kosovës;
2.8 Dëshminë për bashkëfinancim, nëse ka bashkëfinancim dhe
2.9 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

3 Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.

Neni 9
Subvencionet për fushën e bujqësisë

1. Komuna mund të ndajë subvencione për fushën e bujqësisë duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

1.1 Projekte të fermerëve, shoqatave bujqësore, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për komunën;
1.2 Projekte në sektorin e pylltarisë;
1.3 Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim dhe
1.4 Përkrahjen për zhvillim dhe turizëm rural.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në fushën e bujqësisë, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

2.1 Zonave me prioritet të identifikuara nga komuna;
2.2 Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me 20% të vlerës, me përjashtim kur në ftesën

publike është percaktuar ndryshe;

2.3 Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe komuniteteve etnike dhe

2.4 Aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njejtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të ndonjë subvencioni për fushën e bujqësisë, të ndarë nga pushteti gendror ose nga ndonjë donator tjetër.

3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për fushën e bujqësisë nga personat juridikë, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

3.1 Certifikatë të biznesit;

3.2 Projektin dhe planin financiar;

3.3 Certifikatën e pronës;

3.4 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;

3.5 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;

3.6 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj Administratës Tatimore të Kosovës;

3.7 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

3.8 Dokumentin identifikues të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit;

3.9 Dëshmi se nuk është përfitues i një subvencioni të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për fushën e bujqësisë nga personat fizikë, përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

4.1 Dokumentin identifikues;

4.2 Numrin identifikues të fermerit;

4.3 Projektin dhe planin financiar;

4.4 Certifikatën e pronësisë;

4.5 Dëshminë për pagesën e taksave komunale;

4.6 Dëshminë për pagesën e tatimit në prone dhe

4.7 Konfimimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

5. Shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen do të percaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 10
Subvencionet në fushën e shëndetësisë

1. Komuna ndan subvencione në formë të mbështetjes së pjesëshme për qytetarët rezidentë të Komunës së Fushë-Kosovës për përballimin e shpenzimeve të trajtimit, mjekimit ose rehabilitimit shëndetësor, në pajtim me këtë Rregullore dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.
2. Subvencionet nga paragrafi 1 i këtij neni ndahen deri në funksionalizimin e plotë të skemës së sigurimeve shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi.
3. Subvencionet mund të ndahen për rastet si vijon, pa u kufizuar vetëm në to:

3.1 Sëmundje malinje;

3.2 Sëmundje të rënda kronike, të shoqëruara me ç'rregullime të sistemeve të tjera organike, fizike ose mendore;

3.4 Sëmundje për të cilat terapia ose trajtimi i rekomanduar nuk përfshihet në Listën Esenciale të Barnave ose në paketën e shërbimeve të mbuluara nga institucionet publike shëndetësore;
3.5 Terapi dhe rehabilitim pas ndërhyrjeve kirurgjikale, kur trajtimi i rekomanduar zgjat më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj;
3.6 Lehonat me komplikime shëndetësore të paraqitura gjatë periudhës pas lindjes, të vërtetuara me dokumentacion përkatës mjekësor nga institucioni shëndetësor kompetent.
4 Kriteret e përgjithshme - për shqyrtimin e kërkesës, aplikuesi duhet të dorëzojë:
4.1 Formularin e aplikimit të plotësuar;
4.2 Kopjen e letërnjoftimit për personat madhorë;
4.3 Ekstraktin e lindjes për personat e mitur;
4.4 Dokumentacionin përkatës mjekësor, fletëlëshimi i pacientit me epikrizë i vërtetuar nga specialistët mjekësor, shefi i repartit dhe drejtori i klinikës përkatëse.
4.5 Raport specialistik për gjendjen shëndetësore, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e aplikimit;
4.6 Faturat, profaturat dëshmitë e pagesave ose dokumente të tjera financiare që dëshmojnë shpenzimet e trajtimit ose mjekimit;
4.7 Të dhënat për datën e ndërhyrjes së fundit mjekësore, kur është e aplikueshme;
4.8 Diagnozën për të cilën kërkohet subvencionimi dhe
4.9 Konfirmimin e llogarisë bankare të aplikuesit ose përfaqësuesit ligjor.
5 Kriteret specifike për sëmundjet malinje:
5.1 Raport specialistik nga mjeku onkolog;
5.2 Histopatologjia ose dokument tjetër që vërteton diagnozën dhe
5.3 Plani ose protokolli i trajtimit.
6. Për sëmundjet e rënda kronike:
6.1 Raport specialistik nga mjeku kompetent dhe
6.2 Dëshmi për trajtim të vazhdueshëm ose terapi afatgjatë.
7. Për terapitë që nuk përfshihen në Listën Esenciale të Barnave:
7.1 Raport specialistik që arsyeton nevojën për terapi dhe
7.2 Rekomandim mjekësor dhe përshkrim i trajtimit.
8. Për trajtimin pas ndërhyrjeve kirurgjikale:
8.1 Epikriza ose raporti i lëshimit nga institucioni shëndetësor dhe
8.2 Rekomandimi specialistik për trajtim ose rehabilitim afatgjatë.
9. Për lehonat me komplikime pas lindjes:
9.1 Raport specialistik nga gjinekologu ose specialisti përkatës;
9.2 Dokumentacion që vërteton komplikimet shëndetësore të paraqitura pas lindjes dhe
9.3 Vërtetim nga institucioni shëndetësor kompetent.
10 Gjatë vlerësimit të kërkesave, përparësi mund t'iu jepet aplikuesve që gjenden në gjendje të rënduar socio-ekonomike, familjeve përfituese të skemave sociale, personave me nevoja të veçanta, si dhe kategorive të tjera të përcaktuara me vendim të Kryetarit të Komunës.
11 Shuma maksimale e subvencionimit për secilin përfitues përcaktohet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për secilin vit fiskal, në përputhje me mjetet e planifikuara buxhetore.

12. Nuk lejohet financimi i dyfishtë i të njëjtit shpenzim nga fondet publike. Aplikuesi është i obliguar të deklarojë çdo mbështetje financiare të përfituar ose të aprovuar nga institucionet publike për të njëjtin qëllim. Në rastet kur shpenzimi nuk mbulohet plotësisht nga një institucion publik. Komuna mund të subvencionojë pjesën e pambuluar të shpenzimeve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore dhe mjetet e disponueshme buxhetore.
13. Kundër vendimit për refuzimin e kërkesës, aplikuesi ka të drejtë ankese në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa shqyrtohet nga komisioni ose organi kompetent i përcaktuar me akt të veçantë të Komunës.
14. Komisioni për vlerësimin e kërkesave mund të kërkojë dokumente shtesë kur ato konsiderohen të nevojshme për verifikimin e gjendjes shëndetësore ose të shpenzimeve të deklaruara.
15. Drejtoria e Shëndetësisë ka të drejtë të verifikojë dokumentacionin e paraqitur pranë institucioneve kompetente dhe të refuzojë kërkesat që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara.

Neni 11

Subvencionimi i projekteve të Organizatave Jo Qeveritare në fushën e shëndetësisë

1. Komuna e Fushë Kosovës mund të ndajë subvencione për Organizatat Jo Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat zhvillojnë aktivitete dhe zbatojnë projekte e interes publik në fushën e shëndetësisë.
2. Subvencionimi sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të mbështesë projekte që kanë për qëllim:

2.1 Promovimin dhe avancimin e shëndetit publik;
2.2 Edukimin dhe vetëdijesimin shëndetësor të qytetarëve;
2.3 Parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve;
2.4 Promovimin e stileve të shëndetshme të jetesës;
2.5 Përmirësimin e qasjes në shërbime shëndetësore për grupet e cenueshme;
2.6 Organizimin e aktiviteteve humanitare, edukative, profesionale dhe shkencore në fushën e shëndetësisë.

3. Ndarja e subvencioneve për organizatat joqeveritare bëhet përmes thirrjes publike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për financimin publik të Organizatave Jo Qeveritare.
4. Kriteret e përzgjedhjes, dokumentacioni i nevojshëm, procedurat e aplikimit, mënyra e vlerësimit, kushtet e financimit, monitorimit dhe raportimit përcaktohen me thirrje publike dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5 Shuma e subvencionimit përcaktohet në bazë të buxhetit të aprovuar të Komunës dhe vlerësimit të projekt-propozimeve nga komisioni përkatës.

6 Organizatat përfituese obligohen të përdorin mjetet financiare vetëm për qëllimet e aprovuara, të raportojnë për realizimin e aktiviteteve dhe të mundësojnë monitorimin dhe auditimin e projekteve sipas legjislacionit në fuqi.

7 Komuna rezervon të drejtën të kërkojë kthimin e mjeteve të ndara në rast të përdorimit të tyre në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë ndarë ose në rast të mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e financimit.

Neni 12
Financimi dhe bashkëfinancimi i projekteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë

1. Kryetari i Komunës, me propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe në pajtim me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi dhe të financojë ose bashkëfinancojë projekte, programe dhe aktivitete në fushën e shëndetësisë.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit mund të lidhen me institucione publike, institucione shëndetësore publike dhe private të licencuara, organizata jo qeveritare, institute, universitete, organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera relevante që veprojnë në fushën e shëndetësisë.
3. Financimi ose bashkëfinancimi mund të realizohet për:

3.1 Ofrimin e shërbimeve specifike shëndetësore të cilat nuk ofrohen nga institucionet shëndetësore komunale;

3.2 Ofrimin e shërbimeve emergjente dhe specialistike në interes të qytetarëve;

3.3 Zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta në fushën e promovimit, parandalimit dhe mbrojtjes së shëndetit dhe

3.4 Aktivitetet kërkimore, profesionale dhe edukative me interes publik në fushën e shëndetësisë.

4 Marrëveshjet e bashkëpunimit mund të kenë karakter lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar.

5. Kohëzgjatja e marrëveshjeve përcaktohet sipas natyrës së projektit ose programit përkatës dhe nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet, përveç rasteve kur me legjislacionin në fuqi ose me vendim të arsyetuar përcaktohet ndryshe.
6. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, qëllimi i bashkëpunimit, mënyra e financimit, afatet e zbatimit, monitorimi, raportimi dhe mekanizmat e llogaridhënies përcaktohen në marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit.
7. Financimi dhe bashkëfinancimi sipas këtij neni realizohen në përputhje me buxhetin e aprovuar të Komunës dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike.
8. Drejtoria e Shëndetësisë monitoron zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe i raporton Kryetarit të Komunës për realizimin e tyre.

Neni 13
Komisioni për vlerësimin e kërkesave dhe projekt-propozimeve

1. Për vlerësimin e kërkesave për subvencionim dhe projekt-propozimeve, Kryetari i Komunës themelon Komisionin për Vlerësim me vendim të veçantë.
2. Komisioni përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë, të cilët janë zyrtarë të Komunës ose ekspertë të fushës përkatëse.
3. Komisioni shqyrton kërkesat dhe projekt-propozimet në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në thirrjen publike.

4. Komisioni harton raportin e vlerësimit dhe rekomandimin për ndarjen e subvencioneve, të cilin i'a përcjell Kryetarit të Komunës për vendimmarrje.
5. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar të deklarojnë çdo konflikt interesi para fillimit të procesit të vlerësimit.

Neni 14
Monitorimi, raportimi dhe mbikëqyrja

1. Drejtoria e Shëndetësisë është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të subvencioneve, projekteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të financuara nga Komuna.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen të paraqesin raport narrativ dhe financiar për shfrytëzimin e mjeteve të ndara, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshje ose në thirrjen publike.
3. Komuna ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë dhe të kryejë verifikime për të vlerësuar përdorimin e rregullt të mjeteve të ndara financiare.
4. Përfituesit obligohen të ruajnë dokumentacionin financiar dhe mbështetës për periudhën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
5. Drejtoria e Shëndetësisë harton raport vjetor për subvencionet e ndara dhe i'a paraqet Kryetarit të Komunës.

Neni 15
Ndalimi i financimit të dyfishtë

1. Organizatat Jo Qeveritare nuk mund të përfitojnë financim ose bashkëfinancim për të njëjtin projekt, aktivitet ose shpenzim nga më shumë se një drejtori, program ose linjë buxhetore e Komunës së Fushë-Kosovës apo në nivel qeveritar, për project-propozimin e njejtë. Aplikuesi është i obliguar të deklarojë të gjitha fondet e kërkuara, të aprovuara ose të përfituara nga Komuna për projektin përkatës.
2. Në rast se konstatohet financim i dyfishtë për të njëjtin qëllim - Komuna ndërmerr masat për kthimin e mjeteve të përfituara në kundërshtim me këtë Rregullore dhe mund të përjashtojë organizatën nga përfitimi i subvencioneve komunale në përputhje me ligjin.

Neni 16
Subvencionet në fushën e mirëqenies sociale për individë dhe familje

1. Në rast të varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të fatkeqësive natyrore, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me ç'rregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe persona të moshës madhore, të cilët janë persona me nevoja të veçanta dhe që janë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës, Kryetari i Komunës në bazë të kërkesave të arsyetuara, ndan subvencione momentale të njëhershme financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të Komunës.
2. Të drejtë aplikimi për përfitimin e ndihmës momentale dhe të njëhershme, kanë të gjitha familjet apo individët, pavarësisht a janë apo nuk janë shfrytëzues të Skemës së Ndihmës

Sociale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3 Kërkesa për ndihmë momentale të njëhershme, e bërë nga individi/familja, dorëzohet në Zyrën Pritëse në Komunën e Fushë-Kosovës.

4 Familjet apo individët si dhe subjektet juridike jofitimprurëse, për të njëjtën nevojë mund të aplikojnë vetëm një herë brenda vitit kalendarik, përjashtuar rastet e jashtëzakonshme nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, të cilat i konstaton komisioni përkatës nëpërmjet vizitës në terren dhe mund të kërkohet konstatim shtesë i gjendjes socio-ekonomike nga Qendra për Punë Sociale.

5. Mbështetja financiare dhe ndihma momentale e njëhershme nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, përjashtojnë të gjitha pagesat dhe transferet për qëllime kapitale dhe pagesa të kredive apo çfarëdo lloj pagesë e cila nuk përkon me thirrjen, apo nevojën për ndihmë financiare.
6. Këto subvencione janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për familjet individët dhe institucionet joprofitabile.
7. Kërkesa për ndihmë të njëhershme mund të bëhet, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas momentit të ndodhjes së rastit të jashtëzakonshëm.
8. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Fushë-Kosovës, në çdo vit fiskal si dhe në thirrjen publike të shpallur nga Drejtoria për Mirëqenien Sociale.

Neni 17
Qiraja jo profitabile e subvencionuar për pagesë familjeve me gjendje të rëndë sociale të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës planifikimin buxhetor për pagesën e qirave për familjet në nevojë përmes miratimit vjetor të buxhetit.
2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Fushë-Kosovës që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit për arsye të gjendjes së rëndë ekonomike, të cilët jo domosdoshmërisht duhet te jenë përfitues të Skemës Sociale, për gjendjen e secilit aplikant e konstaton komisioni përkatës nëpërmjet vizitës në teren.
3. Numri i familjeve përfituese nga kjo kategori përcaktohet në pajtim me ndarjen buxhetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët, të cilët në Komunën e Fushë-Kosovës janë rezident së paku prej pesë (5) viteve.
5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i komunës nuk mund të kalojë shumën e 50% të çmimit të tregut/qiras për muaj, bazuar në ligjin Nr. 03/L-164.

Neni 18
Përcaktimi i kritereve dhe i radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve në gjendje të nevojës të cilat mund të subvencionohen për pagesën e qirasë

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat dhe

familjet e paraqitura janë:

1.1 Statusi i banimit;
1.2 Lartësia e të ardhurave;
1.3 Gjendja shëndetësore;
1.4 Invaliditeti dhe
1.5 Struktura e familjes.

2. Për secilin kriter të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij nenin, Drejtoria për Mirëqenie Sociale i propozon kriteret specifike, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve për pagesën e qirasë të cilat do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Fushë-Kosovës, për çdo vit fiskal.

Neni 19
Përparësitë në përzgjedhjen e familjeve të subvencionuara

1. Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:

1.1 Familjet me shumë fëmijë;
1.2 Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me nevoja të veçanta;
1.3 Familjet ku kryefamiljari është grua - mbajtëse e familjes;
1.4 Bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë dhe
1.5 Fëmijët me statusin e jetimit.

Neni 20
Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve dhe marrjës së vendimit nga Kryetari i Komunës, aplikanti duhet të sjellë kontratën e qirasë së banimit mes palëve qiradhënësi dhe qiramarrësi, e cila duhet të jetë e lidhur me akt noterial, drejtorisë përkatëse, lidh kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individi që i plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje.
2. Pagesa e qirasë së banimit është e parapar deri në 12 muaj, mbi bazën e kritereve dhe procedurave.
3 Një muaj para se të skadoj kontrata aktive, pala ka të drejtë të aplikoj për pagesën e re të qirasë së banimit, duke ndjekur të njejtat proceduara të aplikimit.

Neni 21
Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qirasë apo shkëputjes së kontratës së qirasë

1. Palës përfituese të subvencionimit të qirasë, i ndërpritet e drejta për pagesë apo shkëputja e kontratës së qirasë, kur:

1.1 Qiramarrësi ka bërë deklarim të rrejshëm për të ardhurat;
1.2 Qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të komunës;
1.3 Qiramarrësi i'a lëshon banesën me qira palës së tretë;
1.4 Qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore

Komisioni Vlerësues i Komunës

1.5 Qiramarrësit i punësohet njëri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale,

1.6 Qiramarrësi i kalon pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës.

Neni 22

Komuna ndan subvencione

1. Për familjet strehuese, të cilët strehojnë fëmijët dhe të rritur pa përkujdesje prindërore.
2. Në varësi të mundësive buxhetore brenda vitit fiskal - Komuna me vendim të Kryetarit të Komunës mund të bejë ndarjen e subvencioneve të njëhershme, për ofrimin e ndihmës për furnizim me lëndë djegëse për ngrohje për familjet në nevojë.
3 Për fëmijët e diagnostifikuar me çrregullime të spektrit autizmit dhe fëmijët me sindromën doën, kriteret e kësaj ndihme përcaktohen në bazë të thirrjes publike.
4 Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Fushë-Kosovës, në çdo vit fiskal nëpërmjet thirrjes publike të shpallur nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

Neni 23

Subvencionimi i projekt propozimeve për Organizatave Jo Qeveritare më fushën sociale

1. Komuna ndan subvencione për Organizatat Jo Qeveritare e licencuara në fushën e shërbimeve sociale.
2. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Fushë-Kosovës, të bazuara në Rregulloren Nr. 04/2017, të cilat do të shpallen publikisht nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Neni 24

Financimi dhe Bashkëfinancimi i projekteve/memorandumeve të bashkëpunimit;

1. Kryetari i Komunës, me propozimin e Drejtorisë përkatëse në bazë të kompetencave të tij/saj mund të lidh dhe financojë marrëveshje bashkpunimi, me insittucione /Organizata Jo Qeveritare/Institute, për ofrimin e shërbimeve specifike emergjente, shërbime të cilat nuk mund të ofrohen nga Komuna.
2. Marrveshjet mund të kenë karakter lokal, regjional dhe nacional.
3. Marrveshjet mund të jenë me afata kohor nga 1 deri në 3 vjet.
4. Obligimet dhe detyrimet për palët e përfshira në proces, përcaktohen në marrveshje të bashkëpunimit.

Neni 25
Subvencionet në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

1. Drejtoria për Shëndetesi dhe Mirëgenie Sociale ndan subvencione si vijon:

1.1 Drejtoria subvencionon në forme të përkrahjes financiare qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës për përballimin e shpenzimeve të shërimit nga sëmundjet e rënda, për rastet emergjente shëndetësore, për familjet që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, për renovimin e objekteve të banimit për qytetarët, të cilet nuk e kanë të zgjidhur problemin strehimit;

1.2 Drejtoria subvencionon projektet dhe aktivitetet e organizatave të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe

1.3 Ndarja e subvencioneve në fushën shëndetësisë sipas kritereve të kësaj rregulloreje do të aplikohet deri në hyrjen në fuqi të ligjit për sigurimet shëndetësore. Kriteret do të rishikohen pas hyrjes në fuqi të ligjit.

2. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim është si në vijim:

2.1 Personat me sëmundje të rënda dhe me kosto të lartë të shpenzimit të mjekimit, e cila do të vlerësohet nga ekspertet mjekësor si pjesë e Komisionit Vlerësues;

2.2 Personat që nuk kanë përfituar nga burimet tjera financiare;

2.3 Personat në gjendje të rendë socio-ekonomike;

2.4 Përparësi kanë aplikuesit që janë nëna vetë-ushqyese-bartëse të familjes dhe

2.5 Për rastet e subvencionimit për renovimin e shtëpive, vlera maksimale është 4,000.00€ për aplikues.

3. Dokumentacioni i përgjithshëm:

3.1 Formulari i kërkesës / aplikacioni;

3.2 Dokumentacioni mjekësor;

3.3 Faturat për shpenzimet e mjekimit;

3.4 Data e intervenimit të fundit;

3.5 Diagnoza për të cilën po aplikon;

3.6 Leternjoftimi kopje për të rriturit;

3.7 Ekstrakti i lindjes për të miturit dhe

3.8 Konfirmimi bankar i xhirollogarisë së aplikuesit.

4. Kriteret specifike të detajuara të cilat do të publikohen, në thirrjen për aplikim do të përpilohen nga Drejtoria dhe të miratohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 26
Subvencionet në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sport

1. Drejtoria subvencionon projekte dhe aktivitete të personave fizikë dhe juridikë nga fushat e kulturës, rinisë dhe sportit, të cilat janë të ndërlidhura me programet e punës së Drejtorisë, me qëllim të avancimit të vlerave dhe fuqizimit të aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore, duke u përkujdesur për procesin e ndarjes së subvencioneve në përputhje me nenet paraprake të kësaj rregulloreje.

2. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i përgjithshëm për aplikim, sipas fushave përkatëse, janë si vijon:
3. Në fushën e Kulturës subvencionohen:

3.1 Arti vizual dhe figurativ: Krijimi i veprave të reja artistike; fuqizimi i artistëve të rinj; organizimi i ekspozitave; hulumtimi kuratorial; instalimet në hapësira publike; mbështetja e personave me nevoja të veçanta; inovacioni teknologjik në art.

4. Botimet: Botime për fëmijë; botime për të rinj; romane; tregime; përkthime; mbështetja e personave me nevoja të veçanta; botime që lidhen me kulturën dhe trashëgiminë kulturore.
5. Festivale: Art figurativ; art në hapësira publike; arkitekturë; ekologji; film; letërsi; festivale shumëdisiplinore; muzikë; folklor; teatër; teknologji informative; vallëzim dhe forma të tjera artistike.
6. Kinematografi: Film dokumentar; film i shkurtër; film i animuar; fuqizimi i kinematografëve të rinj; titrimi i filmave; zhvillimi i skenarëve.
7. Manifestime: Shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shënimi i datave të tjera me rëndësi për Komunën e Fushë-Kosovës.
8. Mbështetje e aktiviteteve vjetore kulturore: aktivitete mujore, programe arsimore, artistike, debate, ligjërata dhe hulumtime; fuqizimi i organizatave dhe operatorëve kulturorë, krijuesve të rinj dhe rezidencave artistike.
9. Muzikë: kompozimi i veprës së re, audio-incizimi, koncertet, fuqizimi i muzikantëve të rinj, mbështetja e personave me nevoja të veçanta dhe inovacioni teknologjik.
10. Organizim: performanca, trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, simpoziume dhe Konferenca.
11. Shoqëri kulturo-artistike: mbështetja e aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrja në festival.
12. Teatër: prodhimi i shfaqjeve, promovimi dhe pjesëmarrja e shfaqjeve në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështetja e personave me nevoja të veçanta dhe inovacioni teknologjik.
13. Trashëgimi kulturore: ciceroni i Fushë-Kosovës, fushata vetëdijësimi, pjesëmarrje aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës, promovimi i diversitetit kulturor në Komunën e Fushë-Kosovës, turizmi kulturor në Komunën e Fushë-Kosovës, platforma informative dhe inovacioni teknologjik.
14. Shpërblime vjetore: vepra më e mirë e vitit, krijuesi i vitit, ngjarja kulturore e vitit, projekti kulturor i vitit dhe operatori kulturor i vitit.
15. Në fushë e rinisë subvencionohen si vijon:

16 Fuqizimi i organizatave rinore: mbështetja e aktiviteteve të Organizatave Jo Qeveritare, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe i atyre të margjinalizuara, pjesëmarrja në seminare, konferenca e tjera, brenda dhe jashtë vendit, mbështetja e ideve dhe projekteve të të rinjve, si dhe promovimi i talenteve të rinj.

17. Edukimi joformal: trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca e tjera;
18. Shpërblime vjetore: vullnetari i vitit, ngjarja rinore e vitit, projekti rinor i vitit dhe organizata rinore e vitit.

19. Në fushën e sportit subvencionohen si vijon:
20. Masivizimi i sportit: masivizimi i sportit për të rinjtë, avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave, integrimi i komuniteteve në aktivitete dhe gara sportive, integrimi i personave me nevoja të veçanta në aktivitete dhe gara sportive, mbështetja e aktiviteteve sportive për fëmijët e Fushë-Kosovë, përkrahja e projekteve me qëllim të zhvillimit të ligave shkollore në nivel lokal dhe rajonal.
21. Ngritja e kapaciteteve në fushën e sportit: përkrahja e klubeve publike sportive, përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet e suksesshme, bashkëpunimi me organizata të ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të projekteve për avancimin e trajnerëve, të cilët punojnë me grupmosha të ndryshme, ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive, si dhe aktivitete edukative me simpatizantë, me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit.
22. Organizime: trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca, mbështetje për personat me nevoja të veçanta e tjera.
23. Shpërblime vjetore: sportistët/laureatët e sportit, shpresa e sportit, ngjarja sportive e vitit, klubi sportiv i vitit dhe individët e inkuadruar në sport si punëtorë profesionalë trajnerë, referë, përzgjedhës, pedagogë, punëtorë sportivë, veteranë të sportit, gazetarë sportive e tjera.

Neni 27
Ndarja e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve për kulturë, rini dhe sport do të bëhet përmes Thirrjeve publike nga Komuna e Fushë-Kosovës. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencioneve përfshijnë:

1.1 Formulari i projekt-propozimit i shkarkuar online dhe i plotësuar;
1.2 Formulari i propozim-buxhetit i shkarkuar online dhe i plotësuar;
1.3 Kopja e certifikatës së regjistrimit të Organizatës Jo Qeveritare në CD vendoset në formatin Pdf;
1.4 Kopja e certifikatës së numrit fiskal në CD vendoset në formatin Pdf;
1.5 Vërtetimi i llogarisë bankare të organizatës nuk pranohet kopja e kartelës bankare;
1.6 Vërtetimi i Administratës Tatimore të Kosovës që dëshmon se organizata nuk ka borxhe tatimore;
1.7 Letërkonfirmimi nga Departamenti për Organizata Jo Qeveritare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme që subjekti është aktiv;
1.8 Deklaratë për financimin e dyfishtë dhe
1.9 Dokumentet që kërkohen sipas kritereve të thirrjes publike.

2. Kriteret Specifike të detajuara të cilat do të publikohen në thirrjen për aplikim do të Përpilohen nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe do të miratohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 28
Subvencionimi nga Kabineti i Kryetarit të Komunës

1. Kryetari i Komunes në formë të drejtperdrejte subvencionon për përkrahje financiare të personave fizik dhe juridik në fushat e papërcaktuara në raste të veçanta sipas nevojës dhe kërkesës për mbështetje financiare.
2. Kryetari i Komunës sipas mundësisë buxhetore dhe interesit të përgjithshëm të Komunës bashkefinancon projekte të cilal kërkojnë mbështetje financiare.
3. Për shqyrtimin e këtyre kërkesave për mbështetje financiare - Kryetari i Komunës themelon një komisioni ad-hoc prej tre (3) anëtarëve.

Neni 29
Thirrja për Aplikim dhe Udhëzuesi per Aplikues

1. Njësia e kërkesës, në rast të shpërndarjes së subvencioneve përpilon thirjen për aplikim dhe udhëzuesin për aplikues sipas programit dhe planeve të tyre të punës.
2. Thirrja publike dhe udhëzuesi për aplikues publikohet përmes Zyrës për Informim duke u publikuar në faqen zyrtare të Komunës, rrjetet sociale të Komunës.
3. Udhëzuesi i thirries për aplikim duhet të përfshijë kriteret për përzgiedhjen e përfituesve.
4. Formulari për përshkrimin e projektit apo kërkesës.
5. Udhëzime për aplikantet duhet të japin informacion mbi arsyet dhe objektivat e thirrjes, kushtet e thirrjes, metodën e aplikimit dhe zbatimit të procedurës së thirrjes dhe duhet të përfshinë informacionin në vijim:

5.1 Data e hapjes dhe mbylljes së thirrjes;
5.2 Të dhënat për mënyrqn e dorëzimit të aplikacioneve dhe adresën për aplikim;
5.3 Të dhënat për kalendarin tentative të realizimit të thirrjes dhe kontraktimit;
5.4 Një përshkrim të problemit i cili synohet të adresohet përmes thirrjes;
5.5 Objektivat e përgiithshme të thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e burimeve financiare;
5.6 Një përshkrim të fushave në të cilat aplikanti mund të parashikojë zbatimin e programeve apo projekteve;
5.7 Shumat më të ulëta dhe më të larta financiare për projekt dhe kohëzgjatja e implementimit të projekteve;
5.8 Aplikantët që kualifikohen për atë lloj të thirrjes, si dhe partnerët, nëse është e aplikueshme;
5.9 Parimet prioritare për dhënien e burimeve financiare në bazë të të cilave kanë përparësi në miratimin e fondeve, mund të ketë një kategori e veçantë e aplikantëve;
5.10 Aktivitetet e kualifikuara për zbatimin e programit ose projektit;
5.11 Kostot e pranueshme të cilat mund të financohen nëpërmjet thirrjes publike;
5.12 Shpenzimet e papranueshme që nuk mund të financohen nëpërmjet asaj thirrje publike;
5.13 Dokumentacioni i detyrueshem dhe jo i detyrueshëm për aplikim në kuadër të programit apo projektit, duke përfshirë formularët e nevojshëm për aplikim dhe dokumentacionin me të cilin dëshmohet plotësimi i kritereve ligjore për tu kualifikuar për mbështetje

financiare publike;

5.14 Kushtet dhe mënyrën e parashtrimit të pyetjeve në lidhje me thirrien dhe mënyrën e shpërndarjes dhe publikimit të përgiigjeve në pyetjet e parashtruara;

5.15 Kushtet dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave dhe

5.16 Informacione mbi kontraktimin e projektit.

6. Udhëzimet e thirrjes mund të korrigjohen apo ndryshohen, por jo më vonë se shtatë (7) dite pune para afatit të fundit për dorëzimin e aplikacioneve dhe të gjitha ndryshimet publikohen në të njëjten mënyrë dhe në të njëjtin vend, si dokument baze.
7. Njësia e kërkesës mund të përdorë formularët e ofruara në Manualin per Implementimin e Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 Mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Jo Qeveritare.
8. Në varësi nga mjetet financiare në disponeshmëri nga njësitë kërkuese ato mund të përsëriten gjatë vitit kalendarik me shpallien për ndarjen e subvencioneve.

Neni 30
Kufizimet në aplikim dhe përzgjedhje për financim

1. Për rastet e kërkesave të cilat e kalojnë vlerën prej: 15,000.00€, kërkesa duhet të parashtrohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, një herë gjatë vitit kalendarik.
2. Personat fizik mund të përfitojnë subvencione deri në vlerën prej: 5,000.00€.
3. Personat fizik dhe juridik mund të përfitojnë subvencione komunale vetëm një herë gjatë vitit kalendarik, duke përjashtuar subvencionet e ndara për persona fizikë në fushën e shëndetësisë, mirëqenie sociale dhe për nevoja ushqimore.
4. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues nëse për të njëjtin aktivitet ka përfituar nga institucionet apo donatorët tjerë.
5. Përfituesi nuk mund të jetë nën hetime, i bankrotuar apo të jetë i mbyllur, të jetë nën administrim të giykatave, të ketë hyrë në marrëveshje me kreditorë, të ketë pezulluar aktivitetet afariste, apo të jetë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje.

6 Përfituesit, përkatësisht personat fizik dhe përfaqësuesit e personave juridik, nuk mund të jenë të dënuar për një vepër që ka të bëjë me sjelljen profesionale me aktgjykim të plotëfuqishëm.

Neni 31
Procedura e Shqyrtimit të Aplikacioneve/Kërkesave

1. Procedurat për shqyrtimin e aplikacioneve/kërkesave janë si vijon:

1.1 Dorëzimi i aplikacionit/kërkeses nga aplikanti në adresën e përcaktuar në udhëzues;

1.2 Pranimi i aplikacioneve/kërkesave;

1.3 Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve/kërkesave;

1.4 Procesi i vlerësimit të aplikacioneve kërkesave;

1.5 Shpallja publike e rezultateve preliminare të vlerësimit të aplikacioneve/kërkesave;

1.6 Periudha e ankiminit/e drejta e ankesës;

1.7 Kontrolla e parë në teren, për subvencionimin e projekteve;
1.8 Miratimi i projekteve;
1.9 Njoftimi i aplikuesit me rezultatin e vlerësimit të projektit;
1.10 Vendimi;
1.11 Nënshkrimi i kontratës në mes të përfituesit dhe Komunës;
1.12 Dorëzimi i kërkesës për pagesë nga përfituesi në Komunë;
1.13 Kontrolla e dytë në teren;
1.14 Masat ndëshkimore në rast të parregullsive gjatë zbatimit të projekleve:
1.15 Ekzekutimi i pagesës dhe
1.16 Monitorimi pas zbatimit të projektit.

2. Shqyrimi administrativ kompletohet brenda 30 ditëve kalendarike.
3. Për projektet, vlerësimi dhe poentimi i aplikimeve të pranueshme duhet të kryhet brenda 45 ditëve kalendarike.

4 Të gjithë aplikuesit duhet të informohen për perzgjedhjen ose refuzimin e projektit /kërkesës së tyre.

Neni 32
Komisioni Vlerësues

1. Përzgjedhja e përfituesve bëhet nga komisioni vlerësues i propozuar nga ana e njësisë kërkuese duke u aprovuar me vendim nga ana e Kryetarit të Komunës.
2. Komisioni vlerësues përbëhet nga 5 anëtarë, përkatësisht dy (2) anëtarë nga Njësia kërkuese njëri prej tyre Kryesues i Komisionit, 1 (një) anëtar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, 1 (një) anëtar nga njëra prej Drejtorive të Komunës, dhe 1 (një) anëtar nga Shoqëria Civile me thirrjen për aplikim, i/e cili/cila gjatë përzgiedhjes prioritet kanë ata të cilët veprojnë në fushën relevante me thirrjen për aplikim.
3. Përveç anëtarëve të regullt të komisionit vlerësues nga paragrafi 2, duhet të parashihet edhe një (1) anëtar rezervë i cili do të zëvendësoj anëtarin e komisionit vlerësues në raste të mungesës, sëmundjes, konfliktit të interesit dhe të tjera.
4. Përbërja e komisionit vlerësues duhel të ketë përfaqësim gjinor.
5. Komisioni vlerësues nuk është organ i përhershëm, por emërohet pas publikimit të thirrjes për aplikim dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit.
5. Komisioni vlerësues është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtë dhe listës së përfituesve përfundimtar.
6. Në përfundim të procedurës së vlerësimit. Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave përpilon një raport/procesverbal të punës dhe të njëjtin e dorëzon tek Drejtori i Njësisë përkatëse, i/e cili/a mbi bazën e rekomandimeve nga raporti, i'a përcjell dokumentacionin Kryetarit të Komunës për vendimmarrje.
7. Në raste të veçanta Kryetari i Komunës mund të kërkojë që komisioni vlerësues të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision te ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

Neni 33
Shërbimet Administrative për Komisionin

1. Njësia e kërkesës shërben si sekretari për Komisionin Vlerësues dhe ka këto përgiegjësi:
1.1 Përcakton datën e fillimit të procedurës së vlerësimit të aplikacioneve, jo më vonë se pesë (5) ditëve të punes;
1.2 Siguron informata, materiale përcjellëse, si dhe udhëzime procedurale për anëtarët e Komisionit dhe
1.3 Bënë publikimin e rezultateve në përputhje me rregulloren për transparencë dhe komunikon me përfituesit sipas raportit vlerësues.

Neni 34
Kriteret e përgjithshme për aplikim

1. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i përgjithshëm që kërkohet nga aplikuesit për të përfituar të drejtën për subvencionim sipas fushave përkatëse i saktësuar në këtë rregullore është indikative dhe ajo do të përcaktohet në detaje përmes thirrjes publike, varësisht nga natyra e thirrjes, kushtet tjera të thirrjes dhe situata aktuale para publikimit të thirjes.
2 Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
3. Implementimi i aktiviteteve të parapara në projektet e subvencionuara, duhet të bëhet vetëm në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Projektet që udhëhiqen nga gratë, të rinjët, personat me nevoja të veçanta dhe komunitetet jo-shumicë kanë përparësi.

Neni 35
Monitorimi

1. Të gjithë përfituesit obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese e paraparë në kontratë.
2. Njësia e kërkesës formon komisionin monitorues të përbërë nga tre (3) anëtarë për monitorimin e të gjitha projekteve/subvencioneve të financuara.
3. Anëtarët e komisionit vlerësues nuk mund të caktohen në komisionin monitories.
4. Procesi i monitorimit, periudha kohore e monitorimit dhe i veprimeve të tjera me interes për njësinë kërkuese, duhet të specifikohet në marrëveshjen e nënshkruar në mes të njësisë kërkuese dhe përfituesit.
5. Gjatë monitorimit të projektit, nëse konstatohet se përfituesi nuk i mirëmban investimet, atëherë ai/ajo do të procedohet sipas procedurave ndëshkimore të përcaktuara në kontratë dhe i njëjti do të vendoset në listën e personave/bizneseve, që nuk do të përzgjidhen për përkrahje në të ardhmen nga Komuna.

Neni 36
Ankimimi

1. Aplikuesit e pakënaqur me rezultatin e vlerësimit kanë të drejtën e ankesës dhe atë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të listës preliminare të përfitueseve.
2. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës, duhet të jep përgjigje me shkrim, me arsyetim të plotë, drejtuar parashtruesit të ankesës.
3. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij, me të cilin:

3.1 Vërteton vendimin e njësisë së kërkesës në lidhje me vlerësimin e projektit përkatës;
3.2 Anulon vendimin e njësisë së kërkesës në lidhje me vlerësimin e aplikacionit/kërkesës përkatës dhe merr vendim meritor në lidhje me projektin përkatës dhe
3.3 Kthen për rivlerësim në njësinë e kërkesës projektin përkatës.

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave mund të kërkojë informacione të nevojshme nga njësia e kërkesës, si dhe të realizojë vizita në teren në lidhje me projektet përkatëse.

Neni 37
Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave

1. Komisioni themelohet me vendim të Kryetarit të Komunës, sipas të cilit përcaktohen mandati, detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
2. Komisioni do të jetë në përbërje prej tre (3) anëtarëve dhe të ketë përfaqësim gjinor. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve përbëhet nga dy Shërbyes Civil, nga të cilët një anëtar duhet të jetë zyrtar ligjor, ndërsa anëtari i tretë duhet të jetë nga Shoqëria Civile.
3. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e mbajtura i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
4. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve, nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.

II. Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Neni 38
Epërsia me ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mospërputhje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi e të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 39
Ndryshimet-plotësimet dhe zbatimi

1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore, do të bëhen sipas procedures së njejtë të aprovimit të kësaj Rregulloreje.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 dite nga publikimi në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe shfuqizon Rregulloren Nr. 83, të datës 14.06.2013, për ndarjen e subvencioneve.

KUVENDI I KOMUNËS
FUSHË-KOSOVË
Rreg. Nr.229 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani